



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

NJOFTIM PËR MEDIAT

1. Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka paraqitur pranë Gjykatës kërkesën me objekt: “Dërgimin për gjykim të çështjes që i përket procedimit penal nr. 74 të vitit 2023, në ngarkim të të pandehurit **Adrian Cani**, i akuzuar për kryerjen e veprës penale “*Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike*”, parashikuar nga neni 245/1 paragrafi i katërt i Kodit Penal”.

2. Gjykimi i kësaj çështje u zhvillua me rregullat e gjykimit të shkurtuar. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me trup gjykues të përbërë nga gjyqtarët Erjon Bani, Flojera Davidhi dhe Ardit Mustafaj, me vendimin Nr. **63**, datë **25.10.2024** vendosi:

1. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Adrian Mustafa Cani**, për veprën penale të “*Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike*”, të parashikuar nga neni 245/1 paragrafi i katërt i Kodit Penal dhe dënimin e tij me **2(dy) vite e 3 (tre) muaj burgim**.
2. Në zbatim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurit **Adrian Mustafa Cani**, i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit të dhënë, duke u dënuar përfundimisht me **1 (një) vit e 6 (gjashtë) muaj burgim**.
3. Në zbatim të nenit 59 të Kodit Penal, urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënien në provë për të pandehurin **Adrian Mustafa Cani**, për një periudhë kohe prej **3 (tre) vitesh**, me kusht që gjatë kësaj kohe mos të kryejë vepër tjetër penale si dhe të mbajë kontakte me Drejtorinë e Shërbimit të Provës që mbulon vendbanimin e tij.
4. Në aplikim të nenit 190 të Kodit të Procedurës Penale, provat materiale, konkretisht një DVD-R, me kapacitet 7.2 GB, emërtuar “Spak” “Fiks Fare”, e datës 20.04.2023, një CD e përcjellë me shkresën nr. 7161 prot, datë 11.07.2023, e kompanisë telefonike Vodafonë të mbeten pjesë e fashikullit.
5. Shpenzimet gjyqësore dhe ato të hetimeve paraprake i ngarkohen të pandehurit.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, brënda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, duke filluar ky afat nga e nesërmja e njoftimit të këtij vendimi.

Tiranë, më datë 25.10.2024

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar